



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet më të fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Dëshmitari i parë i thirrur nga prokuroria në gjykimin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit dëshmoi këtë javë me masa mbrojtëse, kryesisht në seancë private. Dëshmitari u mor në pyetje nga Prokuroria dhe në vijim iu bënë pyetje edhe nga ekipet e Mbrojtjes.

Të gjitha gjykimet para DHS-së janë publike; megjithatë gjykatësit ndonjëherë vendosin ta kryejnë një pjesë të seancës së gjyimit në atë që njihet si seancë private, ose të redaktojnë informacione të caktuara për të mbrojtur identitetin dhe sigurinë e dëshmitarëve ose të viktimave.

Vendimi për t'i kryer seancat në seancë private për të mbrojtur dëshmitarët shqyrtohet me kujdes nga gjykatësit, rast pas rasti.

Gjykatësit sigurohen që të ketë balancë midis nevojës për mbrojtje të dëshmitarëve dhe të drejtave të të akuzuarve. Për shembull, edhe kur dëshmia e dëshmitarit nuk është publike, avokatët e të akuzuarve përsëri kanë të drejtën t'i bëjnë pyetje dëshmitarit nga ana e tyre.

Seanca e sotme në çështjen *Thaçi dhe të tjerët* pritet të përfundojë në orën 16:00. Paraqitja e provave nga Zyra e Prokurorit të Specializuar do të vazhdojë të hënën e ardhshme, 17 prill, në orën 9:00 paradite.

Në çështjen Pjetër Shala, Trupi Gjykses urdhëroi më 6 prill vazhdimin e paraburgimit të të akuzuarit. Trupi Gjykses konstatoi se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Shala të pengojë procedurat ose të kryejë krime të tjera. Trupi Gjykses konstatoi gjithashtu se paraburgimi vijon të jetë i domosdoshëm dhe i arsyeshëm, sepse këto rreziqe nuk mund të ulen mjaftueshëm përmes zbatimit të masave të arsyeshme alternative, por vetëm përmes kornizës së monitorimit të komunikimeve që zbatohet në objektin e paraburgimit të DHSK-së.

Javën e kaluar, DHSK-ja u takua me OJQ nga Kosova dhe Serbia për të diskutuar programin për ndërgjegjësim dhe komunikim të Gjykatës dhe mënyrat se si të shpërndajë informacion të saktë për gjykatën tek sa më shumë njerëz që është e mundur, si dhe u dha atyre mundësinë për të parashtruar pyetje dhe për të shprehur mendimet e tyre.

Pyetje nga gazetarët

